YOU SEE!
PLATFORM FOR SOCIAL INNOVATIONS IN YOUTH EMPLOYMENT

Regional CSO platform advocating social innovation under employment policies that guarantees security for youth at risks, an EU-funded project. This document has been produced by financial assistance of the EU founds of Civil Society Facility Operating Grants to IPA CSO Associations.

LEAD APPLICANT

ADP ZID

CO-APPLICANTS

SEE YN
South East European Youth Network

YCC
YOUTH CULTURAL CENTER
BITOLA, MACEDONIA

BEYOND BARRIERS
We believe in what we do

NAPOR
Omladinska Rada
Nacionalna Asocijacija Praktičara/Ki

lens
progress through technology

tog
TOPLUM GÖNÜLLÜLERİ

The content of this document are the sole responsibility of YOU SEE! project partnership and can under no circumstances be regarded as reflecting the position of the EU.

KOSOVA
që duam

RINIA RURALE E KOSOVËS

Mundësitë, pengesat dhe nevojat për punësim

PËRKRAHUR NGA: FRIEDRICH EBERT STIFTUNG

Botimi i këtij raporti është mbështetur nga Friedrich Ebert Stiftung në Prishtinë

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG
Büro Kosovo

NGO LENS

Sylejman Vokshi 25 kati II, Nr. 6,
10000 Prishtinë

+383 38 74 81 50

www.ngolens.org

info@ngolens.org

Autorët:

Bardha Qirezi
Tringa Nika
Valmir Xhemajli

Botuesi:

LENS

Viti i botimit:

2018

Shënim:

Përmbajta e këtij dokumenti është përgjegjësi e projektit partneritar YOU SEE dhe në asnjë rrethanë nuk reflekton poziocionin e BE-së.

PËRMBAJTJA

Përmbajtja 5
Shkurtesat 6
Figurat 7

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE 9

SHQYRTIMI I LITERATURËS 12
Kush janë rinia rurale 14
Vështrim mbi hulumtimet e mëparshme të LENS mbi rininë rurale 15

METODOLOGJIA 18
Mbledhja e të dhënave 20
Procedurat për sigurimin e cilësisë 21

MUNDËSITË PËR PUNËSIM PËR RININË RURALE 23
Punësimi sipas moshës dhe gjinisë 24
Punësimi sipas komunës 25
Arsimimi dhe punësimi 27
Të martuar dhe të papunë 29
Komunitetet etnike të margjinalizuara 29
Të ardhurat si tregues i tregut të punës 30
Strategjitë për kërkim të punës dhe opsionet e rinisë rurale 31

PENGESAT PËR PUNËSIM TË RINISË RURALE 33
Mospërputhja e fushës së specializimit me mundësitë e punësimit 34
Siguria në punë dhe punësimi informal 36
Family and Financial Dependency 37
Qasja e rinisë rurale në masast aktive të punës 39

NEVOJAT PËR ZHVILLIMIN DHE PUNËSIMIN E RINISË RURALE 40
Preferencat për punë të rinisë rurale 40
Zhvillimi i shkathtësive të buta 41

REKOMANDIMET 42

REFERENCAT 44

Aneks 1. Metodologjia e përzgjedhjes së mostës 46

SHKURTESAT

FES – Friedrich Ebert Stiftung
FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar
AKS – Agjensia e Statistikave të Kosovës
MKRS – Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sportit
MASHT – Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë
MPJF – Ministria e Punësve të Jashtme e Finlandës
MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTI – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NEET – Numri i të rinjve të papunë, që nuk anë në vijim të shkollimit apo trajnimit
OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
SHBP – Shërbimet Publike të Punësimit
RAE – Rom, Ashkali, dhe Egjiptian
BB – Banka Botërore

FIGURAT

Figura 1. Prezantimi i mostrës 9
Figura 2. Prezantimi i mostrës sipas statusit të punësimit dhe gjinisë 9
Figura 3. Prezantimi i mostrës sipas grupmoshës 23
Figura 4. Punësimi sipas grupmoshës 24
Figura 5. Shkalla e punësimit sipas grupmoshës 24
Figura 6. Papunësia e rinisë rurale sipas gjinisë 25
Figura 7. Shkalla e punësimit të rinisë rurale sipas komunës 26
Figura 8. Niveli i arsimit i rinisë rurale 28
Figura 9. Punësimi sipas nivelit të arsimimit 28
Figura 10. Të hyrat e rinisë rurale 30
Figura 11. Kohëzgjatja e kërkimit aktiv të punës sipas rinisë rurale 32
Figura 12. Mënyrat e rinisë rurale për kërkim të punës 32
Figura 13. Pengesat për punësimin e rinisë rurale 33
Figura 14. Profilet e arsimimit të rinisë rurale 34
Figura 15. Mospërputhja e preferencave të rinisë rurale dhe mundësive për punësim 35
Figura 16. Niveli i kënaqshmërisë me punën aktuale 36
Figura 17. Perceptimet e rinisë rurale rreth vendbanimeve të tyre 37
Figura 17.1. Perceptimet e rinisë rurale rreth vendbanimeve të tyre 37
Figura 18. Varësia financiare e rinisë rurale nga familjet e tyre 38
Figura 19. Informimi i rinisë rurale rreth shërbimeve publike të punësimit 39
Figura 20. Faktorët motivues për punësim 40
Figura 21. Nevojat e rinisë rurale të punësuar dhe të atyre të papunë 41

RINIA RURALE E KOSOVËS

Mundësitë, pengesat dhe nevojat për punësim

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky studim paraqet një përpjekje për të ndriçuar rrethanat aktuale të rinisë në vendbanimet rurale, me qëllim të identifikimit të çështjeve kryesore që përfaqësojnë pengesat, mundësitë dhe nevojat për përfshirjen e rinisë rurale në tregun e punës dhe në jetën shoqërore të Kosovës. Rrjedhimisht, ky studim, i cili bazohet në mostrën prej 602 pjesëmarrësve të moshës 15-24 vjeçare në 18 komuna të Kosovës, mund të jetë një ndihmesë për të rritur pjesëmarrjen e rinisë rurale në tregun e punës në Kosovë.

Figura 1. Prezantimi i mostrës

Gjetjet kyçe të këtij studimi tregojnë se të rinjtë e viseve rurale nuk kanë qasje të mjaftueshme në informacion rreth punësimit në Kosovë. Me vetëm 158 (24.62%) të punësuar dhe 436 (75.8%) të papunë, ky studim poashtu tregon se shumica e të rinjve besojnë se posedimi i shkathtësive nuk është kriteri më i rëndësishëm për punësim, pasiqë rekomandimet, dhe lidhjet familjare dhe shoqërore janë mënyrat më të shpeshta për të gjetur punë në Kosovë.

Për sa i takon papunësisë në baza gjinore, rezultatet tregojnë se femrat janë në disavantazh në tregun e punës në raport me meshkujt, me 80.5% të të rejave rurale të papuna, në krahasim me 67.6% të meshkujve të papunë.



Figura 2. Prezantimi i mostrës sipas statusit të punësimit dhe gjinisë

Ky studim tregon se nuk ekziston ndonjë situatë tipike që do të ndikonte në punësimin e të rinjve. Për shembull, shkalla më e lartë e punësimit dhe ajo e papunësisë mund të gjenden në komunat më të vogla. Së këndejmi, shkalla e punësimit është më e larta në Lipjan me 58.1% të të anketuarve të punësuar, e pasuar nga Hani i Elezit me 50% dhe nga Kaçaniku me 46.2 të rinisë së punësuar. Komunat me performancën më të dobët për sa i takon punësimit të të rinjve janë Skënderaj (9.7%), Malisheva (10.4%), Kamenica (10.7%), dhe Deçani (13.3%).[3]

Ky studim poashtu shfaq një raport pozitiv ndërmjet shkallës së arsimimit të pjesëmarrësve dhe shkallës së punësimit të tyre. Kjo shpjegon përse të rinjtë kërkojnë mundësi të studimit për të rritur gjasat e tyre për punësim, me një shumicë të të rinjve që fillojnë studimet universitare dhe me një shkallë prej 60% të të rinjve që kanë prej 14 deri në 18 vite arsimim.[4]

Në anën tjetër, ky studim ka gjetur se deficiti i shkathtësive në raport me mundësitë për punësim, dhe mospërputhja ndërmjet trajnimeve të ndjekura dhe vendeve të punës në zonat rurale, e bëjnë problematik punësimin e të rinjve. Siç theksohet në studime tjera (LENS, 2016), ekziston një mospërputhje ndërmjet shkathtësive dhe kualifikimeve të studentëve me nevojat e tregut të punës.

Sa i përket përfaqësimit të komuniteteve në tregun e punës, ekziston një dallim i madhe mes komunitetit shqiptar me një shkallë të lartë të punësimit prej 28% dhe komuniteteve më të vogla sikurse RAE me shkallë të punësimit prej vetëm 10.7%.

Mungesa e përfshirjes së grupeve të margjinalizuara etnike në arsim dhe në tregun e punës, sidomos e komuniteteve Rom, Ashkali, dhe Egjiptian (RAE), sugjeron ekzistencën e problemeve serioze strukturore që ndikojnë në margjinalizimin e komuniteteve të vogla etnike të Kosovës.

Rezultatet poashtu shpërfaqin faktin se ata që kanë qenë të orientuar në nivele më të larta të shkollimit, kanë filluar punë në fazat e mëvonshme të jetës. Poashtu, studimi tregon se mundësia për të mbetur pa punë për më shumë se një vit rritet në moshë më të madhe.

Roli i zyrave publike të punësimit (SHPP) është i parëndësishëm, pasiqë mënyra më e lehtë për të gjetur punë janë rekomandimet, si dhe lidhjet familjare dhe lidhjet e tjera. Së këndejmi, shumica e të anketuarve besojnë se njohja dhe lidhjet me njerëzit në pushtet mbeten mënyrat më të lehta për të gjetur punë.

3 Gjetjet për Lipjanin janë të ngjashme me gjetjet e Indeksit të konkurrueshmërisë së komunave të bërë nga Instituti Riinvest.

4 Këto të dhëna janë në pajtim me të dhënat e studimit paraprak të LENS, i cili sugjeron se të rinjtë preferojnë vende pune që kërkojnë kualifikime të larta.

Pengesat për punësim janë të ndryshme dhe përfshijnë mungesën e mundësive, mungesën e vendeve të punës me gjysmë orari (për studentët), mungesën e vendeve të punës me orar fleksibil (studentët dhe prindërit e rinj), mungesën e transportit adekuat, dhe mungesën e shkathtësive të duhura të renditur në vendin e fundit. Transporti dhe lidhjet me qendrat urbane nuk janë faktor kryesor për punësim, pasiqë shumica e të anketuarve kanë qasje në transport publik apo privat.

Rezultatet e studimit tregojnë se shumica e të anketuarve janë të kënaqur me vendin aktual të punës. Sidoqoftë, më shumë se gjysma e të anketuarve të punësuar punojnë pa kontratë të punës. Shumica e të anketuarve kanë thënë se fshati i tyre nuk ofron mundësi të mira për punësim. Megjithatë, ata jetojnë në komunitete të organizuara mirë, në ambiente tëshëndetshme dhe me lidhje të mira me qendrat urbane, që e lehtëson kërkimin për punë.

Edhe pse kushtet e jetesës së rinisë rurale janë të kënaqshme, pavarësisht prej shkallës së lartë të papunësisë, niveli i varësisë nga përkrahja e familjes është e lartë. Kjo varësi rritet nga remitancat nga jashtë dhe nga skemat e asistencës sociale. Me një mbështetje të tillë, pavarësisht prej shkallës së lartë të papunësisë, pothuajse të gjithë të anketuarit kanë telefona mobilë, kompjuterë dhe llaptopë, TV, vetura personale apo familjare dhe mjete të tjera shtëpiake.

Paga nuk është faktori kryesor i motivimit për shumicën e rinisë rurale të intervistuar. Ambienti në punë dhe liria e shprehjes janë të renditura si faktorët kryesorë motivues, të pasuara nga kolegët e mirë, orari i punës, mundësia për avansim profesional, dhe niveli i pagës që renditet në vendin e pestë.

Shumica e të rinjve të papunë ne viset rurale kanë nevojë për punë, pasuar nga aftësia për të shkruar biografinë (CV), vlerësimin e shkathtësive të tyre, përdorimin e teknologjisë informative (TI) dhe internetit, këshillim për karrierë, lehtësim për punësim, etj. Kjo përputhet me gjetjet e studimeve paraprake, sipas të cilave shkathtësitë e buta, siç janë shkathtësitë e komunikimit, të qenit të hapur ndaj aktiviteteve sociale dhe të qenit të hapur ndaj kulturave organizative të ndërmarrjeve, janë shkathtësitë kryesore të kërkuara nga punëdhënësit.

Studimi i bërë nga LENS gjatë kësaj vere mund t'u ndihmojë të rinjve, institucioneve publike dhe ndërmarrësve privatë të gjejnë mënyra për të përputhur nevojat dhe kërkesat e tyre në atë mënyrë që do të rriste punësimin e të rinjve, posaçërisht të atyre që jetojnë në viset rurale të Kosovës.

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë pengesat, mundësitë, dhe nevojat e të rinjve në viset rurale për përfshirje më të mirë në tregun e punës në Kosovë. Qëllimi i tij është poashtu, të ofrojë informacione të dorës së parë që do të ishin të dobishme për palët e interesit që të reduktojnë papunësinë e rinisë rurale në Kosovë. Shkalla e papunësisë është treguesi kyç i kushteve në tregun e punës dhe mund të përdoret si mjet për të matur shëndetin e përgjithshëm të një ekonomie. Siç thotë Rutkowski, shkalla e lartë e papunësisë në një periudhë të gjatë kohore tregon ekzistimin e problemeve të thella strukturore (Rutkowski, 2006, p.19).

Njëkohësisht, siç thekson Farčnik (2007), papunësia ka ndikim negativ në qeveri dhe shoqëri në njërën anë, dhe në të papunët në anën tjetër. Përderisa papunësia e rëndon buxhetin e qeverisë, një pjesë e të cilit shpenzohet në skema të të papunëve, ajo poashtu është e dëmshme për punëkërkuesit, sepse shpeshherë çon në dobësimin e shkathtësive dhe në demoralizim (Farčnik, 2007). Prandaj, nivelet e larta të papunësisë kërkojnë vëmendje të menjëhershme, gjë që arsyeton rëndësinë e përfshirjes së papunësisë si pjesë kyçe e agjendës ekonomike të një vendi. Në kontekstin e Kosovës, pavarësisht prej rritjes së vazhdueshme ekonomike në vitet e fundit, niveli i papunësisë ka mbetur i lartë me përafërsisht 30% (KAS, 2018; Riinvest Institute, 2017).

Shkaqet më të shpeshta të niveleve të lartë të papunësisë për një periudhë të gjatë në Ballkanin perëndimor, duke përfshirë këtu edhe Kosovën, janë të ndërlidhura, por jo të kufizuara me rigjiditetin e tregut të punës, mospërputhjen e sistemit arsimor me nevojat e tregut të punës, nivelin e lartë të ekonomisë joformale, margjinalizimin etnik, dhe përjashtimin social (Banka Botërore, 2012; FMN, 2012, p.83; OSBE, 2013, p.12).

Rreth dy të tretat (2/3) të popullatës së Kosovës është në moshën e punësueshmërisë (mosha 15 – 64); dhe pritet që ky numër të rritet gjatë dekadës së ardhshme me hyrjen e më shumë të rinjve në moshën e punës (KAS et al., 2015). Niveli më i ulët i papunësisë përfshin moshën 55-64 vjeç me nivelin e vlerësuar prej 15.2%. Në anën tjetër, niveli më i lartë i papunësisë përfshin moshën 15-24 vjeç me nivelin e vlerësuar prej 61% (KAS et al., 2015).

Së këndejmi, raporti i papunësisë së të rinjve me të moshuarit është 2.0, që tregon se të rinjtë në Kosovë kanë gjasa dyfish më të vogla për t'u punësuar në raport me ata mbi moshën 24 vjeçare (KAS et al., 2015).

Prandaj, të rinjtë përfaqësojnë grupin më të prekshëm për sa i takon papunësisë në Kosovë. Papunësia e të rinjve i referohet papunësisë së njerëzve të moshës 15-24 vjeç, dhe arriti një nivel prej 52.7% në vitin 2017 (KAS, 2018). Këto nivele aq të larta të papunësisë kanë pasoja më të gjëra për stabilitetin socio-ekonomik dhe politik të vendit. Natyrisht se kjo do të ketë ndikim negativ në zhvillimin e gjithmbarshëm dhe të qëndrueshëm të vendit dhe është posaçërisht e dëmshme për strukturën sociale, ekonomike, dhe demografike të Kosovës.

Për shkak të mungesës së vendeve të specializuara të punës, Kosova tanimë po ballafaqohet me probleme të mëdha si pasojë e papunësisë së të rinjve, siç është p.sh. "rrjedhja e trurit" për shkak se punëtorët me kualifikime të larta po e braktisin vendin në kërkim të kushteve më të mira ekonomike dhe avansim profesional. Përveç kësaj, të rinjtë në përgjithësi këkojnë çdo mundësi për të lëshuar Kosovën, siç u pa në braktisjen masive të Kosovës gjatë viteve 2014-2015 për në vendet e BE-së (Qirezi, 2015).

Të dhënat tregojnë se mbi 55% e Kosovarëve të rinj deklarojnë synimin e tyre për t'a braktisur vendin, nëse u jepet një mundësi e tillë (Flere et al., 2015, p.42). Kosova poashtu ballafaqohet me një shkallë të lartë të NEET (numri i të rinjve të moshës 15-24 vjeç që nuk janë as të punësuar, as që vijojnë shkollimin apo trajnime) që shkon në 27.4% të numrit total të popullsisë rinore (KAS, 2018). Një pjesë e madhe e NEET, përveç që bëhen punëtorë të dekurajuar, shpeshherë angazhohen në ekonominë joformale dhe si të tillë kanë kushte të pafavorshme të punës siç është mungesa e sigurisë në punë, paga më të ulta sesa minimum i pagës mesatare, mungesa e beneficioneve në rast të sëmundjes apo pensionimit (Farčnik, 2007).

Sidoqoftë, të rinjtë kanë gjetur një mënyrë pozitive për t'iu përgjigjur gjendjes së rëndë në punësim, duke qëndruar më gjatë në sistemin arsimor, duke e vonuar përfshirjen e tyre në tregun e punës dhe njëkohësisht, duke i rritur gjasat e tyre për të gjetur punë përmes kualifikimeve më të larta të fituara në arsim (LENS, 2015).

Me të vërtetë, papunësia është shndërruar në një fazë normale të procesit të tranzicionit prej shkollës në punë. Megjithatë, të rinjtë janë më të prekur nga papunësia sesa të tjerët. Një numër i madh i hulumtimeve mbi papunësinë e të rinjve mbeten të përqëndruara në rininë e viseve urbane; dhe edhe pse shumica e problemeve me të cilat ballafaqohet rinia urbane janë të ngjashme me ato të rinisë rurale, këta të fundit ballafaqohen me pengesa shtesë si rrjedhojë e mundësive më të kufizuara dhe pozitës gjeografike më të largët të tyre (Cartmel & Furlong, 2000, p.1; Shucksmith, 2004, p.45).

Kush janë rinia rurale

Nuk ka definim gjërësisht të pranuar se kush përbën rininë rurale, por të gjitha definimet kanë si emërues të përbashkët moshën dhe lokacionin. Përderisa disa prej definimeve të rinisë përfshijnë grupmosha të ndryshme, ky studim bazohet në definimin e Kombeve të Bashkuara (OKB) që përfshin të gjithë individët e moshës prej 15 deri në 24 vjeç.

Termi 'rural' është shumë më i komplikuar sepse njerëz të ndryshëm kanë qëndrime të ndryshme rreth asaj se çka përfshin termi 'urban' dhe termi 'rural.' Për më tepër, është debatuar se definimet akademike dallojnë shumë nga kuptimi i këtyre koncepteve nga njerëzit e zakonshëm dhe kështu vetëm se mund të rrisin konfuzionin (Jacob and Lubloff, 1995; Pahl, 1996). Së këndejmi, për të qenë më gjithpërfshirës, termi 'rural' përfshin një sërë pozitash të ndryshme gjeografike (Cartmel and Furlong, 2000, p. 2). Kështu, tipe të ndryshme të viseve rurale janë identifikuar në këtë mënyrë:

i. viset tradicionale rurale që janë të izoluara gjeografikisht
ii. viset në periferi të zonave urbane, ku punësimi është i afektuar nga afërsia me viset që kanë popullsi më të dendur
iii. viset sezonale, në të cilat vendet e punës në ndonjë sektor të rëndësishëm hapen gjatë sezonës (p.sh. turizëm, bujqësi)
iv. viset rurale ish të industrializuara në të cilat tërheqja e industrive prodhuese dhe eksploatuese ka rënë shumë përgjatë viteve (Cartmel & Furlong, 2000, p.2)

Në Kosovë, 64.8% të të rinjve jetojnë në viset rurale (KAS, 2018). Rinia e viseve rurale ballafaqohet me pengesa shtesë në punësim dhe në shkollim, në krahasim me rininë urbane. Arsimimi dhe trajnimi profesionale kanë mbetur të pazhvilluara në viset rurale të Kosovës (Bajema et al., 2002; FES, 2016, p.9). Përveç kësaj, të rinjtë në viset rurale ballafaqohen me mungesë të mundësive për rrjetëzim social, mungesë të vendeve të mira të punës, transport publik të pazhvilluar, dhe kosto të larta të banimit në viset urbane (Cartmel & Furlong, 2000, p.2). Hulumtimet kanë treguar se në afat të gjatë, këto pengesa çojnë në margjinalizim social dhe përjashtim të rinisë rurale, gjë që zbeh më tutje mundësitë e tyre për punësim (Cartmel & Furlong, 2002). Prandaj, është shumë me rëndësi që të reduktohet ndarja urban-rural dhe të përmirësohet lidhja e viseve rurale me zhvillimin ekonomik.

Vështrim mbi hulumtimet e mëparshme të LENS mbi rininë rurale

Më shumë se 60% e popullsisë së Kosovës, pra shumimca, jetojnë në vise rurale (KAS, 2018). Prandaj, rinia e papunë e viseve rurale përfaqëson shumicën e numrit të gjithmbarshëm të të papunëve në Kosovë. Hulumtimet e mëparshme të LENS kanë identifikuar rininë rurale si pjesën më të prekur nga papunësia, që është rrjedhojë e pozitës së saj të margjinalizuar dhe qasjes më të vogël në trajnim profesional dhe në vende të punës (LENS, 2015). Mungesa e zhvillimit të ekonomisë rurale konsiderohet si pengesa kryesore në zgjidhjen e çështjes së punësimit të të rinjve në viset rurale.

Me faktin se ekonomia e Kosovës është në masë të madhe ekonomi shërbyese, me tregtinë dhe ndërtimtarinë si sektorët kryesorë të ekonomisë dhe që funksionojnë kryesisht në viset urbane, dhe si pasojë e vendeve të pakta të punës në bujqësi, në industrinë ushqimore dhe sektorët e tjerë të rëndësishëm për punësimin e të rinjve në viset rurale, ka nevojë për qasje inovative për nxitjen e industrive që përkojnë me zhvillimin ekonomik të viseve rurale dhe për rritje të mundësive ekonomike dhe sociale të të rinjve në viset rurale. Duke u mbështetur në këtë, LENS, i përkrahur nga Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung (FES), zyra në Kosovë, ka ndërmarrë këtë hulumtim që ta vështrojë këtë çështje nga poshtë-lartë, në mënyrë që të identifikohen nevojat dhe çështjet e shfaqura nga të rinjtë në viset rurale.

LENS ka bërë hulumtim mbi papunësinë e të rinjve në Kosovë me të dhënat që i ka mbledhur në periudhën në mes të shkurtit dhe qershorit të vitit 2015. Qëllimi i hulumtimit ka qenë ndriçimi i çështjeve specifike që kanë të bëjnë me papunësinë e të rinjve në nivel vendi, të hedhë dritë mbi praktikat inovatore sociale që do të nxisnin punësimin e të rinjve dhe të identifikimi i grupeve më të margjinalizuara të të rinjve në kontekstin e punësimit dhe aktiviteteve shoqërore.

Ky hulumtim u bazua në të dhënat e Qeverisë së Kosovës, përkatësisht të tri ministrive që kanë të bëjnë me punësim – Ministrisë së punës dhe mirëqenies sociale (MPMS), Ministrisë së tregtisë dhe industrisë (MTI) dhe Ministrisë së kulturës, rinisë dhe sporteve (MKRS). Përveç kësaj, gjatë hulumtimit u mblodhën të dhëna nga intervistat e thella me pronarë biznesesh në njërën anë dhe të rinjve në anën tjetër.

Tri të gjetura relevante nga dokumentet e shqyrtuara janë se MPMS, e cila merret me programet e punësimit, nuk ka një cak të posaçëm për punësimin e të rinjve; se grupi më i cenueshëm i të rinjve janë gratë, sidomos për sa i takon pushimit të lehonisë, që i bën ato më pak të dëshirueshme për punëdhënësit për arsye të ngarkesës financiare për sektorin privat që krijojnë dispozitat ligjore mbi pushimin e lehonisë [3], dhe se punësimi i të rinjve vështirësohet nga kapaciteti i ulët absorbues i tregut të punës së bashku me shkathtësitë joadekuate të të rinjve pas përfundimit të shkollimit.

Që të dyja palët (të papunët dhe punëdhënësit) kanë vështirësi për të përmbushur nevojat reciproke. Përderisa të rinjtë e papunë ballafaqohen me vështirësi për të gjetur punë, punëdhënësit shpeshherë e kanë të vështirë të gjejnë të rinj të punësueshëm që posedojnë shkathtësi të nevojshme për punë. Kjo do të mund të adresohej më mirë përmes organizimit më të mirë të informacionit mbi ofertën dhe kërkesën për punë (LENS, 2015, p.16).

Punëkërkuesit e rinj dhe të papërvojë kanë vështirësi të veçanta për të gjetur punë sepse punëkërkuesit zakonisht kërkojnë shkathtësi që nuk përputhen me konkurset, madje as për vendet bazike të punës (LENS, 2015, p. 17). Ekziston poashtu një hendek në mes të shkathtësive të kërkuara dhe rrogave të ofruara ng punëdhënësit, posaçërisht në sektorin privat (LENS, 2015, p. 17).

Punëdhënësit ankohen se sistemi arsimor nuk i përgatitë të rinjtë për nevojat e industrisë. Megjithatë, ata nuk ofrojnë trajnim në vendin e punës, edhe pse mungesa e përvojës është një ndër problemet më të mëdha që ata kanë identifikuar. Përveç kësaj, punëdhënësit poashtu ankohen lidhur me kulturën e të rinjve që mund të përshkruhet si 'qëndrim i gabuar lidhur me punën' (LENS, 2015, p. 17). Kjo tregon se ekziston një nevojë për zhvillimin e shkathtësive të buta tek të rinjtë, sidomos shkathtësive kulturore e sociale, siç janë komunikimi verbal dhe me shkrim e të ngjashme.

Shkathtësitë më të kërkuara nga punëdhënësit janë ato shkathtësi që do t'i bëjnë punëkërkuesit të përshtatshëm për organizatën, siç janë: shkathtësitë ndërpersonale, përvoja e mëparshme e punës, besueshmëria, përshtatshmëria, kurse shkathtësitë teknike mund të mësohen në punë (LENS, 2015, p. 18). Prandaj, programet e trajnimit që ofrojnë këto shkathtësi janë të domosdoshme për t'i përputhur nevojat e dyanshme të tregut të punës.

Sa i përket mundësive dhe mënyrave të kërkimit të punës, punëkërkuesit besojnë se lidhjet familjare dhe korrupsioni janë mënyrat më efektive për t'u punësuar në Kosovë (LENS, 2015, p. 19). Ne sektorin privat, lidhjet familjare dhe jo kualifikimet, janë kriteri kryesore për të punësuar dikë, ndërsa në sektorin publik vendet e punës edhe ashtu janë të pakta (LENS, 2015, p. 19).

3 Pushimi i lehonisë në Kosovë është i rregulluar me Ligjin No.03/L –212 mbi punën, Neni 49 që lejon pushimin e lehonisë në një maksimum prej 12 muajsh. Gjashtë muajt e parë kompenzohen nga punëdhënësi me 70% të pagës bazë, tre muajt e tjerë paguhen me 50% të pagës mesatare nga Qeveria e Kosovës, kurse tre muajt e fundit mund të jepen si pushim pa pagesë për të punësuarit që dëshirojnë t'a zgjasin pushimin e tyre (Ligji No.03/L –212 mbi punën, 2010, Neni 49)

Zyrat e punësimit nuk janë institucione atraktive për punësim as për punëkërkuesit as për punëdhënësit. Shumica e punëkërkuesve që janë të regjistruar në zyrat e punësimit janë persona me kualifikime të ulta dhe rastet sociale që regjistrohen për të marrë beneficionet sociale si parakusht për të marrë trajnim profesional. Rreth 30,000 familje janë pranues të asistencës sociale. Ekziston një besim i përhapur në mesin e punëkërkuesve dhe punëdhënësve se zyrat e punësimit nuk ofrojnë mundësi të mira për asnjërën palë.

Në anën tjetër, hapja e biznesit është deri diku e vështirë për shkak të korrupsionit dhe procedurave të vështira administrative dhe zakonisht ndodh kur një ndërmarrës ka fituar përvojë disa vjeçare si i punësuar (LENS, 2015, p. 20).

Hulumtimet e mëparshme raportojnë se të rinjtë nuk kanë informacion të duhur lidhur me mundësitë e punësimit, zgjedhjet për karrierë dhe mbi arsimimin (LENS, 2015, p. 20). Raportet e ndryshme qeveritare nuk ofrojnë udhëzime të duhura të karrierës për të rinjtë, kurse të diplomuarit kanë vështirësi të posaçme të gjejnë punë dhe shkojnë në shkollim të mëtejshëm për shkallë më të larta akademike dhe kështu mbeten pjesë e fuqisë punëtore pa përvojë pune (LENS, 2015, p. 21).

Në anën tjetër, të rinjve duket se nuk u pëlqejnë punët që nuk kërkojnë kualifikime, duke përfshirë vendet e punës në ndërtimtari, pastrim apo përkujdesje për fëmijët. Kjo mund edhe të jetë pasojë e politikës së qeverisë për t'i hapur dyert e universiteteve dhe kolegjeve private gjërësisht pa procedura të duhura apo fare pa procedura të pranimit në bazë të meritës.

Hulumtimet tregojnë se të rinjtë nuk janë aktiv për shkak të mungesës së insentivave. Prandaj, të rinjtë e familjeve me të ardhura të vogla ose të familjeve me asistencë sociale mbeten të përjashtuar në pikëpamje sociale dhe nuk munden të marrin pjesë në trajnime dhe të angazhohen në mënyrë aktive në tregun e punës. Poashtu, gratë dhe nënat vetushqyese janë të margjinalizuara për shkak të çështjeve kulturore dhe mungesës së kapaciteteve/vullnetit të sektorit privat për të dhënë pushim të lehonisë i cili kërkon pagesë nga punëdhënësi për 6 muaj (LENS, 2015, p. 23).

Poashtu, pakicat etnike janë të margjinalizuara dhe nuk kanë qasje në zyrat e punësimit. Përndryshe, nuk ka diskriminim në përzgjedhje nga ana e bizneseve, për arsye se pakicat përfaqësojnë fuqinë punëtore më pak të paguar (LENS, 2015, f, 24). Megjithatë, paragjykimet e përhapura ndaj grupeve të tjera etnike ndikojnë në vendimet e bizneseve për të punësuar punëtorë nga grupet tjera etnike (LENS, 2015, p. 24). Gjithashtu, ekziston një mungesë e vullnetit nga ana e punëtorëve të tjerë për të punuar së bashku me RAE dhe punëtorë të grupeve të tjera etnike, si dhe me njerëz me aftësi të kufizuara (LENS, 2015, p. 24-25).

METODOLOGJIA

Synimi kryesor i këtij studimi është identifikimi i mundësive, pengesave dhe nevojave për masa aktive të punësimit të të rinjve të moshës 15-24 vjeçare në viset rurale të Kosovës. Rezultatet nga anketa e realizuar do të shërbejnë për përpilimin e politikave dhe rekomandimeve që do të ndikojnë në avancimin e rinisë rurale neë tregun e punës në Kosovë, dhe në ekonomi në përgjithësi.

Termi rini përdoret sipas definimit të UNESCO (2017) për personat prej 15-24 vjet. "Organizata e kombeve të bashkuara (OKB), për hir të konsistencës statistikore në të gjitha regjionet, e definon 'rininë' si ata persona të moshës ndërmjet 15-24 vjeçare, pa paragjykuar definimet e tjera të shteteve anëtare. Të gjitha statistikat e OKB-së mbi rininë bazohen në këtë definicion, siç ilustrohet në vjetarët e përvitshëm të statistikave që botohen nga sistemi i OKB-së mbi demografinë, arsimin, punësimin dhe shëndetësinë." Ky definim është kompleks dhe nuk shpjegon faktorët tjerë kontekstual që formësojnë problemet e rinisë dhe tranzicionin e tyre në kategorinë e të rriturve.

Për shembull, Ligji për edukimin dhe trajnimin e të rriturve në Republikën e Kosovës No. 04/L-143(2013) konsideron të rritur çdo person që mbush moshën 15 me pritjet që personat në këtë moshë e përfundojnë shkollimin e obliguar dhe mund të angazhohen në punë. Ligji i Punës, Ligji i Famljes, dhe Ligji për Zgjedhje konsiderojnë të rritur çdo person që mbush moshën 18 vjeç, ku fiton të drejtën të votojë, të martohet dhe të ketë punë të rregullt. Këto definime janë interpretime ligjore sepse nuk përfshijnë indikatorë të tjerë si pavarësinë (e banimit dhe financiare), krijimin e familjes, dhe ngjarjet dramatike si jetën në skamje, ballafaqimin me luftën, humbjen e familjarëve, sëmundje, si dhe faktorë tjerë demografikë dhe kulturorë.

Ky studim bazohet në hulumtim primar të kryer përmes një pyetësori të strukturuar me të rinjtë e moshës 15-24 vjeçare që jetojnë në viset rurale, që përkojnë me popullatën e këtij studimi. Hulumtimi është bërë në vendbanime rurale të qyteteve ku mbi 60% e popullsisë banojnë në viset rurale. Duhet përmendur se përjashtimi i vetëm është komuna e Fushë Kosovës e cila është përzgjedhur për shkak të diversitetit etnik pasi përfshin disa pakica etnike dhe grupe të margjinalizuara të cilat ndikuan pozitivisht në rritjen e përfaqësueshmërinë e mostrës. Poashtu, studimi inkorporon të dhëna nga burimet dytësore me qëllim të krahasimit apo vërtetimit të gjetjeve.

Duke patur parasysh vështirësinë dhe koston e intervistimit të mbarë popullsisë, është zhvilluar një mostër përmes metodës së probabilitetit të mostrës. Studimi bazohet në një mostër prej 602 të anketuarve, përmes të cilës përfaqësohet popullata e targetuar.

Aneksi 1 tregon popullsinë e moshës 15-24 në komunat e përzgjedhura dhe përzgjedhjen e numrave të mostrës. Siç u tha më lartë, mostra përfshin komunat ku më shumë se 60% të popullatës rinore jeton në zona rurale, dhe numri i të anketuarve është përcaktuar në bazë të numrit të popullatës rinore, me një margjinë gabimi prej 4.0.

Mbledhja e të dhënave

Të dhënat mbledhen me anë të pyetësorit të strukturuar i cili administrohet nga intervistuesi. Pjesëmarrja në anketim ka qenë vullnetare; të anketuarit kanë mbetur anonim dhe u është garantuar konfidencialitet rreth informatave të dhëna në pyetësor. Përzgjedhja e të anketuarëve nga komunat e përzgjedhura është bërë në mënyrë të rastisishme duke pëdorur parimet në vijim:

• Vetëm vendbanimet rurale (fshatrat) janë përfshirë në anketim; minimum tre fshatëra me largësi të ndryshme nga qendra urbane
• Përgjedhja e shtëpive është bërë varësisht nga densiteti i shtëpive dhe numri i respondentëve. Nuk është caktuar çdo e pesta shtëpi por as nuk janë përzgjedhur shtëpitë rend ose grup i të rinjëve të gjetur në një lokacion.
• Kur është lejuar qasja në hulumtim, fillimisht familjet janë pyetur nëse kanë famlijarë të grupmoshës 15-24. Nëse më shumë se një familjar i përkiste kësaj grupmoshe, intervistuesi përzgjedhte familjarin i cili kishte datën e lindjes (muajin) më të afërt pasues nga data e intervistimit si në shembullin e mëposhtëm:

Data e intervistimit 27/6/2018
Familja 1:
F1 (25 Prill) F2 (20 Tetor) F3 (17 Korrik)
Zgjedhet familjari 3 (17 Korrik)

Arsyeja e kësaj përzgjedhjeje ka qenë që të shmangen intervistimet në një shtëpi dhe të sigurohet përzgjedhja e rastësishme.

Procedurat për sigurimin e vlësisë

Pyetësori ka përfshirë lloje të ndryshme të pyetjeve si psh: pyetje po/jo, pyetje me përgjigje të shumëfishta, pyetje të hapura, dhe pyetje të shkallës likert. Logjika e kapërcimit është përdorur për pyetjet e ndërlidhura me arsimim dhe punësim kur një seri e pyetjeve nuk aplikoheshin tek i anketuari. Fillimisht, pyetësori është pilotuar te dy njerëz nga grupi i targetuar dhe intervistuesit janë trajnuar se si t'i bëjnë intervistat.

Monitorimi është bërë nga menaxhuesi i të dhënave për të siguruar se hulumtuesit mbledhin të dhënat në viset rurale sipas kritereve të përcaktuara. Përveç kësaj, si vijim janë realizuar telefonata të rastësishme me të anketuarit për të siguruar vërtetësinë e pyetësorit.

Futja e të dhënave dhe cilësia poashtu janë monitoruar dhe është bërë pastrimi i të dhënave para analizimit të tyre. Të dhënat sasiore pastaj janë transferuar në programin kompjuterik SPSS sipas skemës së parakodimit dhe janë analizuar. Masat e qendrës dhe të shpërndarjes janë përdorur për të nxjerrë mesataren dhe devijimin standard të mostrës dhe janë shfrytëzuar më vonë për renditje në pyetjet e shkallës likert.

'Cross-tabulations' janë përdorur për të analizuar të dhënat kategorike dhe për të eksploruar përmbajtjen e përgjigjeve të shumëllojshme. Dhe në fund, korrelacioni i Pearson-it është përdorur për të konstatuar nëse ka ekzistuar korrelacion ndërmjet nivelit të arsimimit të të anketuarve dhe nivelit të arsimimit të prindërve të tyre. Rezultatet pastaj janë krahasuar me të dhëna dytësore si një mbështetje shtesë për konkluzionet e studimit.

RINIA RURALE E KOSOVËS

Mundësitë, pengesat dhe nevojat për punësim

MUNDËSITË PËR PUNËSIMIN E RINISË RURALE

Të rinjtë e anketuar janë ndarë në dy grupmosha kryesore: grupi i parë i të rinjve të moshës 15-18 me 249, apo 41.4% të pjesëmarrësve në anketim, dhe grupmosha e dytë e të rinjve të moshës 19-24 me 352, apo 58.6% të pjesëmarrësve. Nga mostra e përgjithshme, 54.8% ishin meshkuj dhe 44.7% femra.



Figura 3. Prezantimi i mostrës sipas grupmoshës

Punësimi sipas moshës dhe gjinisë

Rezultatet prezantojnë grupmoshën e dytë në pozicion më të mirë për sa i takon punësimit, me një shkallë të punësimit prej 38.3%, përderisa grupmosha e parë tregoi shkallën e punësimit me vetëm 10.1%. Figura 4. tregon shpërndarjen e punësimit sipas grupmoshës.



Figura 4. Punësimi sipas grupmoshës



Figura 5. Shkalla e punësimit sipas grupmoshës

Të dhënat e papunësisë do të rriten ndjeshëm për numrin e gjithmbarshëm të të rinjve të anketuar me vetëm 158 (24.62%) të punësuar dhe me 436 (75.8%) të papunë.

Për sa i takon papunësisë sipas gjinisë, rezultatet tregojnë se femrat janë në një pozitë më të keqe sesa meshkujt në tregun e punës, me 80.5% të femrave të reja rurale të papuna krahasuar me 67.6% të meshkujve të papunë.



Figura 6. Papunësia e rinisë rurale sipas gjinisë

Punësimi sipas komunës

Lipjani është performuesi më i mirë në çështjet e punësimit me 58.1% të të anketuarve të punësuar, pasuar nga Hani i Elezit me 50% të të anketuarve të punësuar, dhe nga Kaçaniku me 46.2% të të rinjve rural të punësuar.

Komunat me performancën më të dobët në punësimin e rinisë rurale janë Skënderaj (9.7%), Malisheva (10.4%), Kamenica (10.7%) dhe Deçani (13.3%).

Duhet të theksohet se gjetjet për Lipjanin janë të njëjta me gjetjet e Indeksit të konkurrueshmërisë së komunave nga Instituti Riinvest, i cili vlerëson lehtësinë e të bërit biznes dhe rolin e qeverisjes ekonomike në sigurimn e ambientit të favorshëm të të bërit biznes në nivel lokal, në të cilin Lipjani u rendit si performuesi më i mirë.



Figura 7. Shkalla e punësimit të rinisë rurale sipas komunës

Arsimimi dhe punësimi

Të dhënat poashtu tregojnë se sa më i lartë niveli i arsimimit i të anketuarve, aq më e lartë është shkalla e punësimit. Për sa i takon nivelit të arsimimit, 1.7% e të anketuarve nuk kanë kurrfarë arsimimi formal, ndërkaq 16% e kanë përfunduar vetëm shkollimin fillor. Këtu duhet të sqarohet se shkolla fillore në Kosovë përfundohet në moshën 14-15 vjeçare, prandaj që të dyja grupmoshat janë bashkuar në këtë pyetje.

Shumica, apo 46.7% janë duke vijuar apo kanë përfunduar shkollimin e mesëm. Sidoqoftë, informacioni më i rëndësishëm përbën numrin e të anketuarve të grupmoshës 19-24 vjeçare shkalla më e lartë e arsimimit të të cilëve është shkollimi i mesëm. Këta përbëjnë 32.8% të kësaj grupmoshe dhe vetëm 43.4% e tyre janë të punësuar, kurse 56.6% i takojnë NEET.

Për më shumë, 23.3% e respodentëve kanë kryer 14 vite të shkollimit formal, që nënkupton dy vite të studimeve universitare, dhe 8.6% kanë 16 vjet shkollim të përfunduar, që nënkupton se kanë të përfunduar studimet Baçelor. Për më tepër, një total prej 3.7% kanë 18 vjet shkollim që tregon përfundimin e studimeve Master. Ky studim poashtu eksploroi korrelacionin në mes të nivelit të arsimimit të prindërve me nivelin e arsimimit të fëmijëve të tyre dhe rezultatet tregojnë një trajektore të vogël lineare (pozitive) të korrelacionit (Pearson r =.329, and Pearson's r = .289 për korrelacionin e arsimimit të babait dhe nënës respektivisht, p=0.01). Këto rezultate janë të ndikuara nga numri i madh i nxënësve të cilët ende janë në vijim të arsimimit dhe i atyre të sapodiplomuar. Prandaj, të dhënat e nivelit të tyre të arsimimit nuk janë krejtësisht të besueshme, pasiqë nuk dihet nëse ata kanë për qëllim të vijojnë studimet universitare.Për sa i takon punësimit, njëlloj sikur në studimin e mëparshëm të Farcnik (2007), rezultatet tregojnë se shkallë më të larta të shkollimit rrisin gjasat e punësimit (shih Figurën 3).

Të dhënat poashtu tregojnë se shumica e të rinjve vazhdojnë studimet universitare, ku rreth 36.5% e të rinjve kanë ndërmjet 14 deri në 18 vite arsimim. Këto të dhëna përputhen me të gjeturat paraprake të LENS, që sugjeronin se të rinjtë preferojnë vende pune që kërkojnë kualifikime më të larta. Natyrisht, këto të dhëna janë të ndërlidhura me politikën e Qeverisë së Kosovës për të rritur numrin e studentëve në universitetet e reja publike si dhe tek ofruesit privatë të arsimit të lartë në përpjekje për të reduktuar presionin për punësim dhe për të reduktuar shifrat e papunësisë së të rinjve pasi që të rinjtë e regjistruar në studime universitare nuk numërohen si të papunë (Qirezi, 2017).



Figura 8. Niveli i arsimimit i rinisë rurale

ARSIMIMI DHE PUNËSIMI



Figura 9. Punësimi sipas nivelit të arsimimit

Të martuar dhe të papunë

Për sa i takon gjendjes civile, shumica dërrmuese e të anketuarve (87.5%) janë beqarë, 0.8% jetojnë me partnerë por nuk janë të martuar ligjërisht, 11% janë të martuar ligjërisht, dhe 0.3% janë të shkurorëzuar. Nga grupi të martuar ligjërsht më shumë se 50% kanë të përfunduar vetëm shkollën e mesme. Sipas, Bennell (2017), ky është një tregues i qartë se të rinjtë zgjedhin martesën si alternativën e vetme për të ndjekur, si pasojë e mungesës së mundësive për arsimim dhe punësim.

Komunitetet etnike të margjinalizuara

Për sa i takon përfaqësimit të komuniteteve në arsim, nga 560 të anketuar shqiptarë, vetëm 4 nuk kanë fare arsimim formal, 87 kanë përfunduar shkollën fillore dhe shumica, ose 261 kanë të përfunduar shkollën e mesme. Të gjitha këto kategori, që përfaqësojnë 62% të mostrës janë fuqi punëtore e pakualifikuar.

Nga 38% të mbetur, 24.2 % vijojnë studimet universitare, 9.1% kanë përfunduar studimet Baçelor, dhe 3.9% kanë përfunduar studimet Master. Për dallim prej kësaj, nga 19 Rom, Ashkanli dhe Egjiptian, 26.3% nuk kanëfare arsimim, 31.5% kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 36.8% kanë përfunduar shkollën e mesme dhe vetëm një është student i nivelit baçelor. Asnjë pjesëmarrës që përfaqëson këto komunitete nuk ka ndonjë nivel më të lartë të arsimimit të përfunduar.

Duke pasur parasysh se arsimimi fillor është i detyrueshëm, shkalla prej 26.3% e rinisë së paarsimuar është alarmante sepse tregon probleme të thella strukturore, posaçërisht për sa i takon përfshirjes së këtyre komuniteteve të margjinalizuara në arsim.

Për sa i takon përfaqësimit të komuniteteve në punësim, komuniteti shqiptar ka 28% të shkallës së punësimit, që është gati e njëjtë me shkallën e punësimit në Kosovë e cila është 26.9% (KAS et al., 2014).

Komuniteti shqiptar përfaqëson shumicën e popullsisë në Kosovë dhe si i tillë, është i përfaqësuar më mirë në tregun e punës. Në anën tjetër, komuniteti RAE ka shkallë tepër të ulët të punësimit prej 10.7%, që mund t'i atribuohet pozitës së tyre të margjinalizuar dhe barrierave shoqërore me të cilat ballafaqohet ky komunitet (LENS, 2015).

Për sa i takon moshës kur të anketuarit kanë filluar punën e parë, shumica e të anketuarve kanë filluar punën e parë në moshën 18 vjeçare, kurse 14.7% kanë filluar punën e parë para moshës 15 vjeçare.

Rezultatet poashtu tregojnë se ata qëkanë filluar punën në fazat e mëvonshme të jetës së tyre, kanë bërë kështu sepse janë orientuar drejt niveleve më të larta të arsimimit.

Të ardhurat si tregues i tregut të punës

Një aspekt tjetër kyç i ndërlidhur me rininë në tregun e punës janë pagat. Rezultatet tregojnë që shumica e të anketuarve (40.3%) të punësuar paguhen përafërsisht prej 200 deri në 349€, 17.6% paguhen nën 199€, dhe 27.7% paguhen nga 350 deri në 499€. Në anën tjetër, 10.5% e të anketuarve paguhen nga 500 deri në 699€, dhe 3.2% paguhen prej 700 deri në 1,000€, dhe që të dyja grupet kanë të përfunduara nivele të shkollimit mbi arsimimin e mesëm që arsyeton pagat e tyre të larta.

Një analizë e detajuar e pagave sipas sektorit tregon se shumica e të rinjve (87.8%) janë të punësuar në sektorin privat. Sektori privat poashtu paguan pagat më të larta, duke përfshirë të gjitha rastet e këtij studimi me pagë ndërmjet 500 dhe 1,000€.



Figura 10. Të hyrat e rinisë rurale

Strategjitë për kërkim të punës dhe opcionet e rinisë rurale

Studimi poashtu eksploroi kohëzgjatjen e papunësisë së rinisë rurale, mënyrat se si gjejnë punë dhe informimin e tyre rreth zyrave të punësimit, sidhe pengesat me të cilat ballafaqohen ata kur kërkojnë mundësi punësimi.

Të anketuarit u pyetën se sa kohë kishin kaluar duke kërkuar punë në mënyrë aktive dhe rezultatet tregojnë se shumica, apo 73.6% kishin kërkuar punë prej 0-6 muaj para se të gjenin punë. Në anën tjetër, 13.2% anketuarve të tjerë kishin kërkuar punë aktivisht në një periudhe prej 6 deri 12 muaj para se të punësoheshin dhe pjesa tjetër thanë se kishin kërkuar punë më gjatë se 12 muaj.

Nga të anketuarit kërkimi aktiv i punës sëtë cilëve kishte zgjatur më shumë së 6 muaj, 78.5% i takonin grupmoshës 22-24 vjet. Kjo gjetje është e ngjashme me hulumtimet e bëra nga Agjensioni i statistikave të Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës (MFAF) dhe Banka botërore (2014), të cilat sugjerojnë se gjasat për të mbetur pa punë mbi një vit rriten me moshë. Një çështje tjetër e rëndësishme për sa i takon punësimit të të rinjve është mënyra me të cilën ata kërkojnë dhe gjejnë punë.

Mënyra më e shpeshtë me të cilën rinia rurale kërkon punë është përmes aplikimit online për punë (36.2%), rekomandimeve (29.2%), konkurseve të shpallura përmes rrjeteve sociale (23.3%), punësimit jashtë vendit (15.3%), konkurseve në gazetat lokale (17.3%), dhe 13% kanë konkurruar drejtpërdrejtë në kompani.

Në anën tjetër, 22.6% kanë vazhduar studimet, 10.6% kanë marrë pjesë në trajnime, 8% kanë aplikuar për emigrim, 0.7% kanë kontaktuar ekipet mobile tëpunësimit, dhe vetëm 3.3% kanë konkurruar përmes zyrave të punësimit.

Megjithatë, për sa i takon mënyrës se si kanë gjetur punë, 17.4% e të anketuarve të punësuar thanë se janë punësuar përmes rekomandimeve dhe 38.1% thanë se janë punësuar përmes njohjeve dhe lidhjeve familjare. Për më tepër, 31% e të anketuarve thanë se janë punësuar përmes konkurrimit në shpallje për vende pune dhe një numër shumë i vogël prej 2.6% janë punësuar përmes zyrave të punësimit.

Këto të gjetura janë në pajtim me hulumtimet e kaluara që thonë se rreth 56% të të rinjve në Kosovë besojnë fuqishëm se njohja dhe lidhjet me njerëzit në pushtet janë mënyrat më të lehta për të gjetur punë (Flere et al., 2015; Rrumbullaku, 2018).

Njëkohësisht, punëdhënësit poashtu thonëse mënyrat më të shpeshta të punësimit përfshijnë rekomandimet nga miqtë apo partnerët afaristë (33%), konkurset e hapura (24%), lidhjet dhe njohjet familjare (23%), rrjetet sociale (12%) dhe zyrave të punësimit (8%) (Instituti Riinvest, 2017).

Figura 11. Kohëzgjatja e kërkimit aktiv të punës sipas rinisë rurale



Figura 12. Mënyrat e rinisë rurale për kërkim të punës

PENGESAT PËR PUNËSIM TË RINISË RURALE

Barrierat më të shpeshta që vështirësojnë punësimin e të rinjve rural janë: mungesa e vendeve adekuate të punës (17.9%), mungesa e vendeve të punës me gjysmë orari (14.3%), mungesa e fleksibilitetit të orarit të punës (14.3%), mungesa e transportit adekuat për punë (14.3%), pasuar nga pamundësia për të punuar për shkak të obligimeve familjare dhe përkujdesjes ndaj fëmijëve (14.2%). Pengesat e tjera të renditura më poshtë janë të ndërlidhura me mungesën e vetëbesimit për të kryer një punë (10.7%), mungesën e përkrahjes nga familja (7.1%), dhe kualifikimet joadekuate (7.1%).

Shumica e të anketuarve thanë se udhëtojnë rreth 20-30 minuta për të shkuar në punë. Rreth 73.4% të pjesëmarrësve kanë qasje të rregullt në transport publik, 15.6% posedojnë vetura, ndërkaq 71.6% përdorin veturat familjare për transport. Prandaj, transporti nuk është faktor kyç që pengon punësimin e të rinjve nga viset rurale. Kjo është në dakord me hulumtimin e R.A. Malatest & Associates Ltd (2002) që thotë se të rinjtë rural nuk kanë kurrfarë pengese apo hezitimi për të udhëtuar apo për t'u bartur në vende urbane.



Figura 13. Pengesat për punësimin e rinisë rurale

Mospërputhja e fushës së specializimit me mundësitë e punësimit

Për sa i takon profilit arsimor, numri më i madh i studentëve (28.5%) vijojnë studimet në fushën e ekonomisë dhe administrimit, pasuar nga matematika, informatika dhe telekomunikacioni me 11.8% dhe juridiku me 11.5%. Profilet e tjera të arimimit përfshijnë arkitekturën (4.2%), bujqësinë (3.5%), kiminë dhe bioteknologjinë (2.8%), dhe edukimin (2.8%).

Ky orientim tregon për mospërputhje mes fushës së studimeve të vijuara nga të rinjtëdhe mundësitë më të mira për tëgjetur punë.

Përderisa rinia rurale preferon profesionet në fushën e ekonomisë (17.3%), matematikës, informatikës, dhe telekomunikacionit (15%), shëndetësisë dhe shërbimeve sociale (9.6%), juridikut (6.3%), dhe arsimit (5%), mundësitëe punës në fshatrat e tyre përfshijnë bujqësinë dhe pylltarinë (56.5%), ndërtimtarinë (44.4%), tregtinë (21.1%), turizmin (19.4%), përpunimin e ushqimit (9.4%), veshmbathjen (8.6%), dhe zdrukthtarinë (9.4%).

Prandaj, siç u tha më lartë, tërinjtëkonsiderojnë se fshatrat e tyre nuk ofrojnë vende pune adekuate sepse ata kërkojnë punë për të cilat nevojitet kualifikim më i lartë që është në pajtim me gjetjet e mëhershme të studimit të LENS.

Ky është poashtu një tregues i qartë i mospërputhjes së shkathtësive dhe kualifikimeve të studentëve me nevojat e tregut të punës dhe është në pajtim me idenë e Shahinit se për shkak të kësaj mospërputhjeje një numër i madh i të diplomuarve mbeten pa pune apo ballafaqohen me vështirësi për të gjetur punë (Shahini, 2017, p.8).



Figura 14. Profilet e arsimimit të rinisë rurale



Figura 15. Mospërputhja e preferencave të rinisë rurale dhe mundësive për punësim

Siguria në punë dhe punësimi informal

Të anketuarit u pyetën lidhur me kënaqshmërinë e tyre me punën aktuale dhe të sqarojnë arsyet e ndërrimit të vendit të punës, nëse kanë bërë një gjë të tillë. Sipas rezulateteve del se 58% të të anketuarve janë të kënaqur me vendin aktual të punës, 12.9% janë të pakënaqur, përderisa një përqindje e lartë prej 28% thanë se janë neutralë (as të kënaqur as të pakënaqur) lidhur me punën e tyre aktuale.



Figura 16. Niveli i kënaqshmërisë me punën aktuale

Për sa i takon arsyeve për ndërrimin e vendit të punës, arsyet më të shpeshta janë paga më e mirë dhe kushtet më të mira të punës. Kështu, ata që kanë ndërruar vendin e punës për shkak të pagës thanë se janë më të kënaqur me punën e tyre aktuale, ndërkaq një shkallë befasuese prej 22% të atyre që kanë ndërruar punën për shkak të kushteve të punës, mbeten të pakënaqur me punën e tyre aktuale, dhe 50% ndihen më të kënaqur me kushtet në punën e tyre aktuale.

Të anketuarit poashtu u përgjigjën në pyetjen se sa janë të brengosur se do ta humbasin vendin e punës dhe 41.1% thanë se janë shumë të brengosur, 32.3% nuk janë të brengosur dhe 26.2% ndjehen neutralë. Njëri prej faktorëve më me rëndësi që ofron siguri për të punësuarit është kontrata e punës. Prandaj, marrëdhënia në mes të shqetësimit rreth humbjes së punës dhe llojit të kontratës u ekzaminua nga afër dhe rezultatet tregojnë se nga grupi i atyre që janë shumë të brengosur një përqindje alarmante prej 57.7% punojnë pa kontratë.

Nga ata më të relaksuarit dhe të pabrengosurit për punën e tyre dolën të jenë ata që punojnë online, janë të vetëpunësuar, kanë kontrata me kohëzgjatje të caktuar të punës, punojnë me gjysmë orari, dhe ata që punojnë në biznese familjare.

Varësia nga familja dhe varësia financiare

Perceptimet e të rinjve lidhur me vendbanimet e tyre (viset rurale) përputhen me rezultatet paraprake të këtij studimi, me vetëm 29% të 172 të anketuarve që konsiderojnë se fshatrat e tyre ofrojnë mundësi të mira punësimi. Kjo përputhet me hulumtimin e Lindsay et al. (2003) që gjen se ekziston një perceptim gati i gjithmbarshëm se mungesa e mundësive është pengesa më e madhe për punësimin e rinisë rurale.

Figura 17. Perceptimet e rinisë rurale rreth vendbanimeve të tyre

Perceptime tjera dominuese të të rinjve për viset rurale përfshijnë: vendi ka numër të madh të diasporës (88.9%), komuniteti është mirë i organizuar (83%), ambienti është i pastër (77.3%), dhe lidhjet me qendrën urbane janë të mira (79.2%). Prandaj, lokacioni nuk paraqet pengesë të madhe për rininë rurale.



Figura 17.1. Perceptimet e rinisë rurale rreth vendbanimeve të tyre

Më se 81.4% të të anketuarve të papunë listojnë prindërit e tyre si burimin kryesor të të ardhurave në familje, 7.8% thanë se vëllezërit dhe motrat ofrojnë të ardhurat për familjen, 3.5% prindërit e partnerit/es, ndërkaq 9.2% marrin të ardhura nga remitancat, 5.7% nga asistenca sociale, dhe 4.9% nga partneri. Numri i të rinjve që ende varen nga të ardhurat e prindërve të tyre është shumë i lartë. Sidoqoftë, duhet shënuar se kjo ka të bëjë me kulturën e përgjithshme në Kosovë, meqenëse shumica e të rinjve vazhdojnë të jetojnë me familjet e tyre edhe pas martesës (Flere et al., 2015).



Figura 18. Varësia financiare e rinisë rurale nga familjet e tyre

Kushtet e jetesës së rinisë rurale, pavarësisht shkallës së lartë të papunësisë, mbeten të kënaqshme me 93% të të rinjve që kanë telefon mobil personal, 82% të të anketuarve në posedim të kompjuterit apo llaptopit, 96% me lidhja të internetit në shtëpi, 99.5% kanë televizorë në shtëpi, 86.5% me veturë personale ose familjare, 98.5% me makinë për larjen e rrobave, dhe 65.7% me enëlarëse në shtëpi.

Qasja e rinisë rurale në masast aktive të punës

Numri tejet i vogël i të rinjve të punësuar përmes zyrave të punësimit është poashtu brengosës dhe tërheq vëmendjen drejt efektivitetit të politikave publike dhe kontributit të qeverisë për reduktimin e papunësisë. Të anketuarit u pyetën lidhur me atë se a kanë informacion rreth rolit të zyrave të punësimit dhe një numër i madh prej 231 të anketuarve apo 33.7% thanë se nuk e dinë rolin e këtyre zyrave

Të tjerët japin këto përgjigje: zyrat e punësimit regjistrojnë të papunët (19.1%), lehtësojnë punësimin (13.7%), shpallin konkurse (17.1%), organizojnë trajnime (9.6%), dhe këshillojnë të papunët (6.6%). Mungesa e informacionit lidhur me rolin e zyrave të punësimit dhe mospromovimi i tyre mund të jetë faktori kyç përse të rinjtë nuk kërkojnë punë përmes zyrave të punësimit.

Figura 19. Informimi i rinisë rurale rreth shërbimeve publike të punësimit

Ky studim poashtu eksploroi qasjen e rinisë rurale në insentiva, grante dhe mundësi të ndryshme për zhvillim profesional. Gjetjet tregojnë se vetëm 12% e të anketuarve kanë përfituar nga skemat e bursave shkollore, vetëm 6.4% kanë marrë pjesë në trajnime profesionale, ndërkaq 34.9% thanë se kanë marrë pjesë në trajnime në vendin e punës. Poashtu, vetëm 8% kanë pranuar grante për pajisje dhe nisma biznesore por që nuk hapën bizneset e tyre për shkak të të qenit pjesë e biznesit familjar; dhe një numër i madh prej 70.3% kanë kryer praktikë, por 61.7% e tyre vazhdojnë të jenë të papunë.

NEVOJAT PËR ZHVILLIMIN DHE PUNËSIMIN E RINISË RURALE

Preferencat për punë të rinisë rurale

Sa i përket faktorëve që motivojnë punëkërkuesit për të zgjedhur një punë, këta të fundit preferojnë më së shumti vendet e punës ku mund t'a shprehin vetveten lirshem (77.2%), pasuar nga bashkëpunonjësit e mirë (76%), orari fiks (75.4%), mundësitë për avansim profesional (74.3%), dhe paga e lartë që befasisht rankohet e pesta me radhë (73.6%).

Poashtu, gjetjet tregojnë se puna në fushën profesionale është e radhitur me ulët se sa faktorët tjerë (72.4%) dhe mund të arsyetohet si përgjigje logjike ndaj mungesës së mundësive të përshtatshme për punësim.



Figura 20. Faktorët motivues për punësim

Zhvillimi i shkathtësive të buta

Njerëzit e ndryshëm kanë nevoja të ndryshme për sa i takon punësimit. Rinia rurale duket se kanë nevojë më së shumti të gjejnë punë (54.6%), të shkruajnë një CV (42.9%), të vlerësojnë shkathtësitë e tyre (69.4%), të përdorin kompjuterë (35.1%), të përdorin internet për të kërkuar punë (38.5%), të marrin këshillime për karrierë (56.6%), lehtësim për punësim (45.4%), të hapin biznes (33.8%), t'a zgjerojnë biznesin (9.8%), të mësojnë të punojnë në bujqësi (14.2%), dhe të mësojnë kujdesin ndaj kafshëve (19.1%).

Nga grupi i të rinjve të papunë, 90.6% thanë se kanë nevojë për punë, 87% kanë nevojë të shkruajnë një CV, 87.6% kanë nevojë për lehtësim për punësim, 86.5% kanë nevojë të përdorin kompjuter, 85% kanë nevojë të përdorin internetin për të gjetur punë, dhe 76% kanë nevojë të vlerësojnë dhe të zhvillojnë shkathtësitë e tyre. Në anën tjetër, nevojat e të rinjve të punësuar dallojnë deri në një masë me 23% të tyre që thanë se kanë nevojë të vlerësojnë dhe të zhvillojnë shkathtësitë e tyre, 29.3% kanë nevojë të hapin biznesin e tyre, dhe 51.8% kanë nevojë të zgjerojnë biznesin e tyre.



Figura 21. Nevojat e rinisë rurale të punësuar dhe të atyre të papunë

REKOMANDIMET

Duke qenë të vetëdijshëm për sfidat me të cilat ballafaqohet rinia rurale si dhe për disavantazhin e tyre në tregun e punës, është e domosdoshme që të zhvillohen politika dhe strategji që e rrisin integrimin e tyre në tregun e punës dhe në ekonomi në përgjithësi dhe që zvogëlojnë papunësinë në Kosovë.

Duke u bazuar në gjetjet e këtij raporti, janë nxjerrë këto rekomandime:

1. Edhepse lokacioni dhe qasja në transport nuk janë renditur si çështje madhore, përmirësimi i transportit publik dhe qasja në transport publik të arritshëm financiarisht mund të rrisin mobilitetin e rinisë rurale dhe pavarësinë nga familja. Ndonëse qasja në viset urbane është letësuar nga përmirësimi i infrastrukturës rrugore, transporti i organizuar mirë dhe i sigurtë mund të rrisë gatishmërinë e të rinjve të kërkojnë punë më larg nga shtëpitë e tyre, e që kjo është posaçërisht e rëndësishme për femrat.

2. Rekomandohet që punëdhënësit të sigurojnë kontrata të punës dhe të fusin në funksion orare fleksibile për të rritur përfshirjen e rinisë rurale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për t'i aktivizuar studentët dhe posaçërisht femrat që të punësohen jashtë viseve të tyre.

3. Qeveria duhet të ndërmarrë masa për të monitoruar zbatimin e ligjit të punës dhe të parandalojë punësimin informal.

4. Qeveria duhet të krijojë insentiva për viset rurale dhe të rrisë integrimin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendit përmes zhvillimit të masave aktive të punësimit që janë në linjë me potencialin për zhvillim ekonomik në vise të ndryshme.

5. Pasi që vetëm një numër i vogël i të rinjve janë të vetëdijshëm për rolin e zyrave të punësimit, dhe për shkak të shkallës e vogël të punësimit përmes këtyre qendrave, rekomandohet promovimi i shërbimeve publike për punësim dhe të ngritja e vetëdijes për shfrytëzim më të mirë.

6. Poashtu, bizneset lokale duhet të kenë insentiva për të rritur bashkëpunimin me zyrat e punësimit për të gjeneruar më shumë vende të punës që do të shpalleshin përmes këtyre qendrave.

7. Rinia rurale ka nevojë për vende që sigurojnë aktivitete sociale, kulturore dhe rekreative për të zhvilluar shkathtësi gjenerike që mund t'i ndihmojë ata për të kërkuar dhe mbajtur punë.

8. Mbajtja e trajnimeve profesionale në shkolla, duke përfshirë trajnimin se si të shkruhet një CV, si të kërkohet punë, si të aplikohet për punë, si dhe zhvillimi i shkathtësive tjera të buta janë çështje kyçe për përmirësimin e tranzicionit të të rinjve në tregun e punës.

9. Organizimi i ngjarjeve që promovojnë rrjetëzimin social dhe profesional të të rinjve nga viset rurale për të parandaluar margjinalizimin shoqëror të tyre.

10. Përderisa ka fakte për mungesë të infomacionit lidhur me mundësitë dhe një mospërputhje mes edukimit dhe ofertës së fuqisë punëtore, shpërndarja e informacionit rreth shkathtësive dhe kërkesave për punë është e domosdoshme për të orientuar dhe lehtësuar tranzicionin e të rinjve nga shkolla në tregun e punës.

11. Masat aktive të punësimit për rininë rurale duhet të marrin parasysh qasje inovative që përfshijnë mundësitë lokale dhe mobilitetin e të rinjve. është befasues fakti që edhe pse një numër i madh i të rinjve kanë përfunduar programe të praktikës, kjo nuk ka çuar domosdoshmërisht në punësimin e tyre. Prandaj, një program special për punësimin e të rinjve, duke përfshirë rininë rurale duhet të zhvillohet për të adresuar punësimin e të rinjve në mënyrë adekuate (Qirezi, 2017).

REFERENCAT

Assembly of the Republic of Kosovo. (2010). Law No.03/L –212 on Labor. Retrieved from http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-212-eng.pdf

Bajema, D., Miller, W. and Williams, D. (2002). Aspirations of Rural Youth. Journal of Agricultural Education, 43(3), pp.61-71.

Bennell, P. (2007). Promoting Livelihood Opportunities for Rural Youth. Knowledge and Skills for Development.

Cartmel, F. and Furlong, A. (2000). Youth Unemployment in Rural Areas. York: Joseph Rowntree Foundation.

Qirezi, B. (2017). Education Snapshot. Feasibility Study for Establishment of Employment Fund. Prishtina: UNDP.

Farcnik, D. (2007). The Labour Market and Youth Unemployment in Kosovo. Ljubljana.

Friedrich Ebert Stiftung (2016). Rinia në udhëkryq, cila është rruga?. Prishtina: FES.

Friedrich Ebert Stiftung (2017). Good Education Policy for a Successful Economy. [online] Prishtina: FES. Available at: http://www.fes-prishtina.org [Accessed 24 Sep. 2018].

Flere, S., Hurrelman, K., Klanjsek, R., Lavric, M., Reimbold, H. and Taleski, D. (2015). Lost in Democratic Transition: Political Challenges and Perspectives for Young People in South East Europe. Berlin: Friedrich Ebert Stiftung.

KAS (2018). Kosovo Agency of Statistics. [online] Available at: http://ask.rks-gov.net/ [Accessed 21 September 2018].

KAS, MFAF and WB (2015). Results of the Kosovo 2014 Labour Force Survey. [online] Available at: http://www.ask.rks-gov.net [Accessed 24 Sep. 2018].

LENS. (2015). National Baseline Report on Youth Unemployment in Kosovo. Prishtina: Friedrich Ebert Stiftung.

Lindsay, C., McCracken, M. and McQuaid, R. (2003). Unemployment duration and employability in remote rural labour markets. Journal of Rural Studies, 19(2), pp.187-200.

Riinvest Institute. (2016). Economic Potentials in Region Centre. Prishtina: Riinvest Institute.

Riinvest Institute. (2017). Përgjigje ndaj Sfidave të Rritjes Ekonomike. Forum 2015. Prishtina: Kosovo Foundation for Open Society.

Riinvest Institute. (2018). Municipal Competitiveness Index 2018. [online] Prishtina: USAID. Available at: http://riinvestinstitute.org/uploads/files/2018/May/11/MCI_Index_-_ENG1526043806.pdf

Shahini, B. (2017). Drejt Një Plani Kombëtar për Arsim: Vendosja e Arsimit si Prioritet Numër Një në Kosovë. Forum 2015. Kosovo Foundation for Open Society, p.8.

Shucksmith, M. (2004). Young People and Social Exclusion in Rural Areas. Sociologia Ruralis, 44(1), pp.43-59.

UNDP (2016). Making the Labour Market Work for Women and Youth. Kosovo Human Development Report 2016. Prishtina: UNDP.

Komuna	Urban	Rural	Mosha 15-19	Mosha 20-24	Totali	%	Mostra 602 të anketuar (4.0% margjina e gabimit
Hani Elezit	0.0%	100.0%	900	831	1,731	1.13%	7
Junik	0.0%	100.0%	572	552	1,124	0.74%	4
Malishevë	14.0%	86.0%	6121	5231	11,352	7.43%	50
Suharekë	18.0%	82.0%	6466	5784	12,250	8.02%	48
Skenderaj	20.0%	80.0%	5243	5088	10,331	6.76%	40
Deçan	22.0%	78.0%	4181	3876	8,057	5.27%	30
Lipjan	24.0%	76.0%	5704	5468	11,172	7.31%	43
Kamenicë	28.0%	72.0%	3752	3295	7,047	4.61%	28
Rahovec	28.0%	72.0%	6253	5380	11,633	7.61%	53
Viti	28.0%	72.0%	5130	4124	9,254	6.06%	36
Istog	29.0%	71.0%	4151	3538	7,689	5.03%	28
Klinë	30.0%	70.0%	4265	3788	8,053	5.27%	27
Gllogoc	31.0%	69.0%	5886	6230	12,116	7.93%	45
Kaçanik	33.0%	67.0%	3395	3161	6,556	4.29%	26
Podujevë	36.0%	64.0%	8499	8277	16,776	10.98%	65
Shtime	38.0%	62.0%	2971	2490	5,461	3.57%	28
Fushë Kosovo	53.0%	47.0%	3207	3133	6,340	4.15%	44
TOTAL			79743	73053	152,796	100%	602

Aneksi 1. Metodologjia e përzgjedhjes së mostrës

KOSOVA
që duam

Rinia Rurale e Kosovës
Mundësitë, pengesat dhe nevojat për punësim

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG
Büro Kosovo